

**Procesverbal**  
**Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar**  
**Mbajtur më datë 28.10.2025**

**Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.**

**Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.**

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA
4. EDMOND KALEMI m
5. ELSA PETRITAJ
6. ERAJD ZAIMI
7. ENVER ÇAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI m
12. MYQERRET HEBIBASI
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA m

**Sekretare e Këshillit** deklaroi kuorumin prej 12 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm

Nën/Kryetarja e Bashkisë znj.Sonila Hysenbelliu

Përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim.

**Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr. 37 prot. të datës 20.10.2025.**

Kryetare e Këshillit kërkoi mirkuptimin dhe miratimin për të shtuar në rendin e ditës projekt-vendimin shtesë “Për mbulimin e kostos (tarifa e ushqimit, kopshti me drekë), nga buxheti i bashkisë, për fëmijët Arli dhe Zeni Gërmenji”.

Kryetare e Këshillit u drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Të gjithë këshilltarët shprehën dakortësi me rendin e ditës.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 09:35

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

**Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 30.09.2025.**

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Këshilltarët shprehin dakortësi .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 09:40

Vota pro: 10, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

**Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave**

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë nga anëtarë e këshilltarët nuk ka shprehur konflikt interesi.

**Pika 4 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shtator 2025”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetarja znj.Sonila Hysenbelliu e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili do të dijë në lidhje me me familjen që ka bërë ndarje abuzive ç’është kjo ndarje abuzive?

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetarja znj.Sonila Hysenbelliu e cila shpreh se fillimet e saja i ka në ndihmën ekonomike në Njësinë Administrative Qendër dhe se është njohëse e mirë e ligjit. Ndarje abuzive quhet kur bëhet ndarje e qëllimshme në gjendjen civile, që do të thotë nëse në një familje prej 4 anëtarësh njëri nga fëmijët punësohet automatikisht në sistem del që nuk mund të jetë përfitues i ndihmës sepse ka të ardhura të mjaftueshme. Që ata të mbajnë dhe kursimet dhe ndihmën bëjnë një ndarje në gjendjen civile ku djali kalon familje më vete.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili pyet se ku jeton djali?

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetarja znj.Sonila Hysenbelliu nuk të jap dot të dhëna sepse nuk e njoh familjen Teuta është ajo që i njeh dhe e di shumë mirë se si është situata.

Me leje fjalën e merr z. Myqeret Hebibasi i cili shpreh se e mban përgjegjësinë për këtë çfarë thua, për drejtimin që ke sot?

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetarja znj.Sonila Hysenbelliu e cila shpreh deri sa kam ardhur këtu e mbajë përgjegjësinë.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se ai/ajo mund të jetojë në Tiranë nuk i del rroga për veten e saj jo më të ndihmojë prindërit.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 10:35

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

**Pika 5 e rendit të ditës “Për ndarjen sipas objekteve të shpenzimit të fondit për emergjencat civile , akorduar nga Ministria e Mbrojtjes si dhe planifikuar nga fondet e veta të Bashkisë për vitin 2025”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se kemi kërkuar gjithmonë që Drejtoria e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të përcaktoj buxhetin gjithmonë është si ju dhe të kaloj në këshill, por të punohet atje ku do drejtori , aje ku ka miq, shok pse mos kalojnë në këshill këto punime siç po kalon sot, me preventiv me skica me ndërhyrje me të gjitha. Pse nuk kalohet dhe buxheti ndërmarrjes kështu.

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili shpreh se është shumë e drejtë kjo çfarë Fikreti shpreh por puna çalon pak sepse ata kanë marë një inxhinier dhe mendojnë që për vitin 2026 do veprojnë për çdo rast.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se ne e dimë që ajo ndërmarrje ka emergjenca por ama ka dhe punime që duhen të kalohen me vendim këshilli.

Me leje fjalë merr z.Neim Gogo i cili shpreh se ne kemi bërë një kalendar për dëgjuesën publike për buxhetin e viti 2026-2028 dhe unë i kam kërkuar Kryetarit të bashkisë, bashkë me ju me Kryetaren e këshillit do të jetë Nën/Kryetarja Sonila Hysenbelliu, Drejtori Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Në qoftëse nuk vjen Drejtori Ndërmarrjes unë përse duhet të vete? Për tu thënë atyre që numri i punonjësve është 370 dhe paga është 80% i buxhetit. Atëherë atë buxhet që ne e vëmë në dizpozicion të komunitetit të ndërmarrjes së shërbimeve publike, të vi drejtori dhe të thoji çfarë kanë bërë, çfarë s'kanë bërë dhe çfarë do bëjnë për vitin 2026-2028.

Me leje fjalë merr znj.Liri Nuhellari e cila shpreh që paraprakisht të bëhet dhe shpërndarja e barabartë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se më shumë fajtorë tek pjesa e Ndërmarrjes së Shërbimeve jemi ne si këshill votojmë hedhim lekët dhe se dim ku venë.

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se ne herën e kaluar e diskutuam, mos të ngrihen probleme të kota. Potomi përvojë pastrimit të rrugës nuk ka marë asnjë lekë tjetër.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh nuk janë probleme të kota janë problemet më kryesore më thuaj çfarë ka marë komuna Vëndreshë, Zhepë. Sa lekë keni shpenzuar për komunën Zhepë?

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se kanë marë pastrimin e rrugëve.

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetarja e znj.Sonila Hysenbelliu e cila shpreh se kemi shpenzuar sepse ka qenë fadroma atje. Kamë qenë Drejtore Kabineti dhe çdo të hënë bëhej mbledhje me drejtorën në varësi dhe me drejtorët brenda në bashki dhe e di shumë mirë planin e punës ku kanë punuar.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se fadroma ka gati një muaj në Gurazez dhe vete te shpia e kryeplakut dhe vetë rri nuk punon

Me leje fjalën e merr z.Myqeret Hebibasi i cili shpreh se nuk është e vërtetë sepse këtë herë është punuar.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh dhe një problematikë në lagjen “5 Shtatori” është një rrugë që ka bërë bashkia me beton 3-4 metër, pjesa tjetër është dhe, dhe ato 5-6 familje as janë lidhura dhe në momentin që do të bjerë shi gjithë dheu do bjerë tek pjesa që është rregulluar. Është bërë shumë bukur, folëm edhe me Kryetarin ta kalojmë në këshill dhe ato 20-30 metër lineare që nuk janë bërë të behët me beton.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:45

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Pika 6 e rendit të ditës “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Skraparit” Profesor Doktor Bahri Musabelliu”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetarja znj.Sonila Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili pyet kush e njeh z.Bahri Musabelliu? A ka ardhur ndonjëherë në Skrapar?

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili shpreh se unë nuk jamë anëtarë këshilli por unë e kam pasur pedagog dhe është një figur e shquar dhe është një nga ata pedagogët që ishte shume i respektuar nga të gjithë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se është dakort është një figurë dashamirëse, ka ndihmuar të gjithë skrapalinjtë .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:50

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 7 e rendit të ditës “Për mbulimin e kostos (tarifa e ushqimit, kopshti me drekë), nga buxheti i bashkisë, për fëmijët Arli dhe Zeni Gërmenji”**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj.Sonila Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:55

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

Për sa i përket raportimit

Raportimi i Ujësjetës u shty për muajin e ardhshëm, për shkak të mosparaqitjes së materialit.

Raportimi i MZSH u shty për arsye personale të përfaqësuesit përkatës.

**Të ndryshme**

Nuk ka

**Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .**

**Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela**

**Kryetare Këshillit Bashkiak: Elsa Petritaj**

**Këshilltarët që firmosin procesverbalin:**

1.Alma Kadiasi

2.Fikret Telha

3.Skerdilajt Jaupllari